



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NOTER  
AGRON T. BAJRI

Rr. "K.K.Mema", P.2, Shk.1, Ap.3, K.1, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mob:0682121580



NR. 218 REP.

NR. 78/2 KOL.

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 02.02.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) para meje noterit Agron T. Bajri, antër i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time me adresë Rr. "K.K.Mema", P.2, Shk.1, Ap.3, K.1, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtme:

**PALA DHURUESE: VALENTINË MARKU**, e bija e Dedë-s, lindur më 18.03.1984, në Velipojë Shkodër dhe banuese në Pulaj Plazh Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me nr.BJ4425719 dhe nr.personal I45318122T, me cilësinë e ortakut të vetëm dhe administratorit të Shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k, me NIPT L82028031I, me seli Tiranë, në ambientet e Qendrës Tregtare Toptani, kati i pestë, Rruga "Abdi Toptani", Tiranë 1001.

**PALA PRANUESE E DHURIMIT: FESTIM HASA**, i biri i Kadri-ut, lindur më 29.04.1978, në Vile, Kukës dhe banues në Rr. "Budi", Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me Nr.BJ4007623 dhe Nr.personal H80429054J.

**Baza ligjore:** Neni 761 e vijues të Kodit Civil, Ligji Nr. 7829 datë 01. 06. 1994 "Për Noterinë", Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, ndryshuar me Ligjin 129/2014.

***Palët e mësipërme më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate dhurimi kuotash si më poshtë:***

Pala dhuruese është ortak i vetëm dhe njëkohësisht administrator i shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik, me NIPT L82028031I.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k, transferon nëpërmjet dhurimit, 30% të kuotës, të zotëruar nga ajo, që përbëjnë 30 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 30 lekë, në favor të Z. Festim Hasa. Pas këtij transferimi pala dhuruese Znj.Valentinë Marku, do të jetë ortak në masën 70 % të kuotës të kapitalit të shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k dhe pala pranuese e dhurimit, Z. Festim Hasa do të jetë ortak në masën 30 % të kuotës të kësaj shoqërie.

### Objekti i kontratës

Pala dhuruese transferon në këtë kontratë me vullnet të lirë e të plotë në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Vendimit të Asamblesë të Shoqërisë me Nr. 1, datë 01.02.2019, 30 % të kuotës, që përfaqësojnë 30 % të kapitalit të shoqërisë të zotëruar prej saj në shoqërinë "Tirana Fit 2" sh.p.k, në favor të palës pranuese të dhurimit, Z.Festim Hasa.

### Deklarime të palëve

Pala dhuruese deklaron se 30% të kuotës që përbëjnë 30 % të kapitalit të shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k me vlerë 30 lekë, do t'ia dhurojë palës pranuese të dhurimit pa asnjë kusht dhe kundërshtim.

Pala pranuese e dhurimit deklaron se është dakort dhe se pranon dhurimin e 30% të kuotës që përfaqësojnë 30 % të kapitalit të Shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k me vlerë 30 lekë në favor të tij dhe shpreh mirënjohjen e tij ndaj palës dhuruese.

### Garancitë

Pala dhuruese deklaron dhe garanton se është e vetmja titullare e ligjshme e pjesës së kuotës që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor, nga palë të treta, fakt ky që provohet edhe nga rezultati 0 i kërimit RBS.

Pala dhuruese merr përsipër zgjidhjen e çdo konflikti që mund të vijë nga palët e treta për të drejtën e pronësisë dhe pas humbjes së pronësisë për 30 % të kuotës.

### Heqja dorë nga të drejtat

Pala dhuruese deklaron nën përgjegjësinë e saj personale, se heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet për pjesën prej 30 % të kuotës të cilat po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate duke deklaruar se nuk ka dhe as do të ketë asnjë pretendim mbi to në të ardhmen.

### Të ndryshme

Pas realizimit të këtij transferimi me nënshkrimin e kësaj kontrate Pala pranuese e dhurimit, bëhet pronar i ligjshëm i 30 % të kuotës, që përfaqësojnë 30 % të kapitalit të shoqërisë "Tirana Fit 2" sh.p.k, ndërsa Pala dhuruese zhvishet tërësisht nga pronësia mbi 30 % të kuotës së saj në shoqëri, duke mbartur të drejtat për pjesën prej 70 % të kuotës në këtë shoqëri.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate palës pranuese të dhurimit i lind e drejta e regjistrimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në çdo institucion tjetër shtetëror apo privat që ai e gjykon të arsyeshëm.

Kontrata u hartua nga unë noteri në 5 (pesë) kopje me vlerë të njejtë juridike, ju lexua palëve me zë të lartë dhe qartë, të cilët e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë u nënshkrua prej tyre duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

Unë, Noteri, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil dhe Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

**PALA DHURUESE**  
**VALENTINË MARKU**

Ortake e vetme e shoqërisë «Tirana Fit 2» sh.p.k

**PALA PRANUESE E DHURIMIT**  
**FESTIM HASA**

*Festim Hasa*

*Valentine Marku*

*Wuy*

TIRANA FIT 2  
L820283311  
TAPTANI CENTER

**NOTER**  
**AGRON T.BAJRI**

# Regjistri i Barrëve Siguruese

RBS



Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,  
"Selvia", Kati V  
TIRANE, SHQIPERI  
TEL/FAX: 355 4 2420005  
TEL: 355 4 2420006  
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-201902011112382  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 01.02.2019  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 11:12:38AM  
Lloji i Kerkimit: D-400-594-550  
Numri i Dokumentit:  
Referenca e Perdoruesit:

### LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

VALENTINE DEDE MARKU  
TIRANA FIT 2 SH.P.K.

